



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Integritet Evropian**

**Mbledhja nr. 43**

**Prishtinë, më 10.05.2016 në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, N- 303**

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN**

**Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Slobodan Petrovi , Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj Gutaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi dhe Kujtim Paçaku,**

**Munguan: Valdete Bajrami, Vjosa Osmani, dhe Time Kadrijaj.**

**Nga Staf mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri**

**Mbledhjen e kryesoi Kryetarja e Komisionit znj.Njomza Emini**

**Në mbledhje u propozua ky;**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.04.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-081 për Energjinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-083 për Falimentimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**9. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**10. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-050 për Kinematografinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**11. Të ndryshme.**

**Kryetarja e Komisionit** , pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen.

Pasi ishte mbledhja e parë pas emërimit si Kryetare e Komisionit tha se ne së bashku do ta vazhdojmë punën dhe shpreson që bashkëpunimi mes anëtarëve të Komisionit nuk do të mungoj ne kryerjen e punëve dhe sfidave që e presin Komisionin, falënderoj anëtarët e Komisionit për pritjen e përzemërt që ia bënë si kryetare e këtij Komisioni.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja konstatoj se Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.04.2016;**

**Kryetarja** e Komisionit pyeti anëtarët se a kanë vërejtje ne procesverbal.

Kryetarja e Komisionit konstatoj se Procesverbali nga mbledhja e dt. 26.04.2016 u miratua pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me përputhshmërinë e këtij Projektligji e legjislacionin e BE-së paraqiti opinionin ligjor .

Pas shqyrtimit dhe verifikimit është konstatuar se Projektligji nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, dhe nuk është e rregulluar në mënyrë specifike me Acquis të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Po ashtu njoftoi se me kërkesë të Komisionit tonë lidhur me këtë Projektligj, Drejtoria për Hulumtime ka përgatitur një hulumtim ne disa shtete te rajonit rreth mënyrës dhe kushteve për pranim të personelit diplomatik në shërbimin e jashtëm, trajtimit të familjeve të personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor dhe si është rregulluar masa disiplinore ndaj tyre,

Në vazhdim hapi diskutimin.

**Arben Gashi-** Pasi Kryetarja e Komisionit e kishte mbledhjen e par, njoftoj se ne mbledhjen e kaluar me kërkesë te deputetes Vjosa Osmani ,komisioni mori vendim që te bëhet një hulumtim lidhur me këtë projektligj se si e kan te rregulluar disa shtete tjera ,hulumtimi rezultojë që ka ngjashmëri me nenet që janë kërkuar për hulumtim, andaj konkluzioni është që Projektligji me amendamente nuk ka vërejtje ne aspektin e legjislacionit te BE-së , kurse ne seancë plenare mund te deklarohen secili që ka vërejtje .

**Pas votimit kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;**

## **Rekomandim**

Projektligji Nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-081 për Energjinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor.

Projektligji Nr.05/L-081 për Energjinë, me amendamentet e Komisionit Funksional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk cenon parimet e legjislacionit të BE-së, dhe është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

*Ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, të deklarohen për këtë projektligj.*

**Pas votimit kryetarja konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë;**

## **Rekomandim**

Projektligji Nr.05/L-081 për Energjinë, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor

Projektligji për Energjinë Elektrike, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së.

Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

*Ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, të deklarohen për këtë projektligj.*

**Pas votimit kryetarja konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë;**

## **Rekomandim**

Projektligji Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

### **6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor

Projektligji për Rregullatorin e Enërgjisë së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së. Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Në vazhdim hapi diskutimin

*Ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, të deklarojnë për këtë projektligj.*

**Pas votimit kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;**

#### **Rekomandim**

Projektligji Nr.05/L-085 për Rregullatorin e Enërgjisë me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

**7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-082 për Gazin Natyror, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor .

Pas verifikimit dhe shqyrtimit, konstatojmë se Projektligji nr. 05/L-082 për Gazin Natyror, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së. Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

*Andaj, ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me votim të deklarojnë për këtë projektligj.*

**Pas votimit Kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;**

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 05/L-082 për Gazin Natyror me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së , mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

**8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-083 për Falimentimin, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor .

Pas verifikimit dhe shqyrtimit, konstatojmë se Projektligji nr. 05/L-083 për falimentimin, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së. Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

*Në vazhdim ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me votim të deklarojnë për këtë projektligj.*

**Pas votimit Kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;**

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 05/L-083 për Falimentimin së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së , mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

**9. Shqyrtimi i projektligjit Nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor .

Pas verifikimit dhe shqyrtimit, konstatojmë se Projektligji nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionin e BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me Acquis të BE-së. Prandaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

*Në vazhdim ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, të deklarohen për këtë projektligj.*

**Pas votimit Kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;**

**Rekomandim**

Projektligji nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së , mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

**10. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-050 për Kinematografinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja** lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinion ligjor .

Në bazë të vlerësimit të Projektligjit 05/L-050 për Kinematografinë, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, dhe janë pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Andaj ky projektligj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

**11. Të ndryshme**

Lidhur me këtë pik nuk u ngrit asnjë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetare e Komisionit,**

**Znj. Njomza Emini**

-----